



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 37 datë 26.10.2023**

**“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM TË NJË SIPËRFAQE PREJ 602 M<sup>2</sup> (KATI PARË) DHE 602 M<sup>2</sup> (KATI DYTË) OBJEKTI “ISH KONVIKTI SAFET SPAHIU”, NË FAVOR TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR, SHOQËRI AKSIONARE ME OFERTË PUBLIKE, ME QËLLIM VAZHDIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE RAJONALE DHE VENDORE PËR QYTETARËT E QARKUT TË SHKODRËS”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.7850 dt.28.7.1994 “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 9 pika 1.2, germa a), nenit 54, germa e/1), të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar, VKM nr.421, datë 02.06.2010 “Për Miratimin e listës përfundimtare (të Pjesshme) të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” të ndryshuar, VKM nr. 302, datë 11.5.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, VKB nr.38, datë 26.7.2022 “Për pjesëmarrjen e bashkisë Shkodër në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, vërtetim nga dokumenti hipotekor me nr.479, datë 19.12.2013, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e bashkisë Shkodër;

**VENDOSI:**

1. Të miratoj dhënien në përdorim pa kundërshtim, për një periudhë 10 (vjeçare) vjeçare, të sipërfaqes prej 602 m<sup>2</sup> (gjashtëqind e dy), kati parë dhe 602 m<sup>2</sup> (gjashtëqind e dy), kati dytë pronë e Bashkisë Shkodër, e rregjistruar në regjistrin hipotekor numër 479, datë 19.12.2013, me numër pasurie 4/49, në zonën kadastrale

- 8594, në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër, shoqëri aksionare me ofertë publike, sipas planimetrive bashkëlidhur.
2. Qëllimi i përdorimit të kësaj sipërfaqe do të jetë ushtrimi funksional i shërbimeve administrative nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër, ku Bashkia Shkodër është aksionare me kuotat 36.33% të Aksioneve të Shoqërisë.
  3. Dhënia në përdorim e pasurisë së sipërcituar do të realizohet përmes një kontrate huapërdorje, ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër.
  4. Ky vendim do të zbatohet pas sistemimit të qendrave shëndetësore në ambiente të tjera, të cilat janë të vendosura aktualisht në pasurinë objekt i këtij vendimi, si dhe pas lirimit të ambienteve aktuale në të cilat ndodhet Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër.
  5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
  6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

  
**Oltion LULI**

Sekretari i Këshillit Bashkiar

  
**Denis Lesha**

Miratuar me 32 vota

Vota Pro 32

Vota Kunder 12

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 2.11.2023